

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi i Hagës, ambasadori gjerman në Kosovë: Nuk e ndryshon përgjegjësinë e ish-Jugosllavisë
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/vendimi-i-hages-ambasadori-gjerman-ne-kosove-nuk-e-ndryshon-pergjegje-i46675
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 18:37:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 18:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5ad7191e45a7d813a7548f8cae23cfb234db10954e7f396cbd7ac21cf005b93d
TEKSTI	c0ae4d6e11843ed162ebb941973e4285073a5396910321132fd44aef0ea289bf
PAMJA	e4c4bffc4c5f601f24a27ad90658645ee5583d23369caec31b09e85052128a6a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	47ad7edf7cfb9b884e238b83dd64a74d3551121a5ba71642de1945e7a80bd64a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	78d6084bfd6cb1be1efaeb014ade0ef1539709e636c33f39308264a405fee6e2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/47ad7edf7cfb9b884e238b83dd64a74d3551121a5ba71642de1945e7a80bd64a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[81 vite burg për 4 ish-liderët e UÇK! 25 vite burg për Thaçin e Krasniqin. Vuçiç: Nuk u dënuan për krime kundër njerëzimit. S'kemi arsye të gëzohemi!](#)

16 Shtator 2026, 09:40

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 16 Shtator 2026, 20:25

Vendimi i Hagës, ambasadori gjerman në Kosovë: Nuk e ndryshon përgjegjësinë e ish-Jugosllavisë

Përmes një deklarate, Rudolph nënvizoi se Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe synimi për një Kosovë të pavarur nuk ishin objekt i gjykimit.



Shkruar nga Vermis



Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Rainer Rudolph, ka theksuar rëndësinë e respektimit të vendimit të gjykatës së Hagës ndaj 4 ish-krerëve të UÇK-së dhe të viktimave.

Përmes një deklaratë, Rudolph nënvizoi se Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe synimi për një Kosovë të pavarur nuk ishin objekt i gjykit.

“Siç theksoi kryetari i trupit gjykues gjatë shpalljes së aktgjykimit, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) nuk ishte në gjyq, sikurse nuk ishte as qëllimi i saj për një Kosovë të pavarur”, thuhet në deklaratën e ambasadorit gjerman.

Rudolph theksoi se Gjermania e ka mbështetur punën e Dhomave të Specializuara që nga themelimi i tyre, duke e konsideruar këtë mekanizëm si një kontribut të rëndësishëm në trajtimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, “në forcimin e sundimit të ligjit dhe në përafrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian”.

Ambasadori gjerman e cilësoi themelimin e DhSK-së dhe bashkëpunimin me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY) si dëshmi të përgjegjësisë së Kosovës për të përballuar të kaluarën e saj.

Sipas tij, përmes këtyre proceseve, Kosova ka treguar se, si shtet i pavarur dhe sovran, po përmbush përgjegjësinë e saj për trajtimin e krimeve të luftës.

Në të njëjtën kohë, Rudolph theksoi se aktgjykimi i shpallur në Hagë nuk e ndryshon përgjegjësinë e aktorëve jugosllavë për luftën dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë viteve '90.

“Aktgjykimi në asnjë mënyrë nuk i shfajëson aktorët jugosllavë nga përgjegjësia për konfliktin e armatosur dhe shkeljet në shkallë të gjerë të të drejtave të njeriut të shkaktuara ndaj popullit të Kosovës në fund të viteve '90”, thuhet në deklaratë./Versus.al

Poll





AKTUALITET

VIDEO/ Haga dënoi 4 ish-krerët e UÇK, Prishtina "skuqet" nga flamujt kuq e zi. Tensione mes qytetarëve dhe policisë para selisë së qeverisë

16 Shtator 2026, 20:15

^ekstrakti^



AKTUALITET

Protesta e 109-të në Tiranë, Dritan Goxhaj flet për dënimin e ish-krerëve të UÇK: Në Hagë u bë padrejtësi!

16 Shtator 2026, 20:05

^ekstrakti^



AKTUALITET

Apelimi i vendimit të Hagës ndaj 4 ish-krerëve të UÇK-së, avokatët mbrojtës: Procesi mund të marrë vite kohë

16 Shtator 2026, 19:44

^ekstrakti^



AKTUALITET

DETAJE nga plagosja në Durrës/ 61-vjeçari qëllloi me armë zjarri ndaj avokatit, shpallet në kërkim nga policia (EMRAT)

16 Shtator 2026, 19:31

^ekstrakti^





AKTUALITET

[Skandal në Hagë/ Specialja e përmendi si person në dijeni për krimet, Fatmir Limaj i pafajshëm nga Tribunali dhe EULEX](#)

16 Shtator 2026, 19:18

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Ishte në kërkim për zhdukjen e verës miliona euro nga kantina e Ergys Agasit, kapet tek "Kodra e Diellit" kushëriri i tij](#)

16 Shtator 2026, 19:01

^ekstrakti^



AKTUALITET

["Krimet kundër njerëzimit u rrëzuan", Vuçiç reagon pas vendimit të Hagës për liderët e UÇK: Nuk kemi arsye të gëzohemi ose të tristohemi!](#)

16 Shtator 2026, 18:39

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Pas vendimit të Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së, nis mbledhja e firmave nga deputetët për zhbërjen e Gjykatës Speciale](#)

16 Shtator 2026, 18:26

^ekstrakti^

Të fundit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.